



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi  
Mbledhja nr. 16 - 2009  
Prishtinë, më 13 maj 2009, ora 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 225

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

**Morën pjesë:** Bahri Hyseni, Bajram Kosumi, Kolë Berisha, Ramadan Gashi, Dzezair Murati, Ibrahim Makolli, Adem Hajdaraj dhe Armend Zemaj.

**Munguan:** Branislav Grbiq, Adem Salihaj dhe Selvije Halimi.

**Të ftuar:** Bedri Bahtiri – përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë.

**Të pranishëm:** Ramadan Islami – OSBE, Rrezarta Ahmeti, Reshit Gashi – NDI, Lejla Selimi - OSBE, Lumnije Murati – ZPRK, Naim Hajdari - EULEX, Harry Matz, Shkumbin Elshani, - US, Embassy, Yrdan Sirakov, Nathalia Berkoviq – EULEX, Blerta Ukmata - EULEX, Drita Miftari – Radio Kosova dhe Ismail Shabani – Bota sot.

**Nga Stafi i Komisionit:** Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit, me këtë:

**REND DITE**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 27 prillit dhe të 4 majit 2009;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar,
4. Të ndryshme.

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari** – Në fillim të mbledhjes, i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi përfaqësuesin e Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësuesit e Zyrës Amerikane, përfaqësuesit e EULEX – it, organizatat që e mbështesin punën e Komisionit dhe i njoftoi të pranishmit për rendin e ditës.

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të 27 prillit dhe të 4 majit 2009;**

**Kryetari** – I pyeti anëtarët se a kanë vërejtje eventuale për procesverbalin.

*Procesverbali u miratua pa vërejtje*

## **3. Shqyrtimi i Projektligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar**

**Kryetari** - Në diskutimin e tij shtoi se edhe në mbledhjen e kaluar të Komisionit kemi diskutuar për këtë projektligj dhe i kemi hartuar edhe disa propozimamendamente, për të cilat sot do të diskutojmë në Komision. Shtoi se kemi edhe disa komente nga Zyra Amerikane, nga ajo e EULEX-it dhe nga përfaqësuesit e tyre të pranishëm në këtë takim. Këta do ta shprehin opinionin e tyre. I pranishëm është edhe përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë, Bedri Bahtiri, i cili do ta sqarojë edhe pjesën strukturore të këtij projektligji.

**Armend Zemaj** – Ishte i mendimit se sot në mbledhjen e Komisionit do të duhej të ishte e pranishme Ministria e Drejtësisë, në mënyrë që të shohim mendimin politik të saj për këtë projektligji.

**Kryetari** – Duke u ndërlidhur me parafolësin sqaroi se: ne ftesën ia kemi dërguar Ministres së Drejtësisë dhe pajtohem se ndoshta më mirë do të ishte që të jetë ajo pranishme, por edhe pjesëmarrja e Bedri Bahtirit, udhëheqës i Zyrës Ligjore të kësaj ministrie, është në rregull. Mendoj se për këtë çështje ata janë marrë vesh. Duke diskutuar për Projektligjin shtoi se ne kemi marrë edhe disa propozime nga zyrat ndërkombëtare.

**Kryetari** –Theksoi se edhe në takimin e kaluar ishim të mendimit të ndryshohet titulli i projektligjit dhe fjala “*menaxhim*” të zëvendësohet me fjalën “*administrim*”, kurse lidhëza “*apo*” të zëvendësohet me “*ose*”. Këto propozime u miratuan nga anëtarët e Komisionit.

**Bedri Bahtiri** – Në fjalën e tij shtoi se ky amendament i propozuar për titullin e Projektligjit është i qëlluar, sepse në praktikë po përdoret së tepërmi fjala menaxhim.

Amendamenti i dytë i propozuar nga anëtarët e Komisionit ishte që fjala “Agjension” të zëvendësohet me fjalën “Agjenci”. Edhe ky amendament u miratua nga anëtarët e Komisionit.

**Armend Zemaj** – Vuri në pah se nuk është me rëndësi titulli i Projektligjit, por fushëveprimtaria e tij. Pyeti cila është arsyeja e formimit të këtij Agjencioni? Pse nuk është formuar si departament dhe a janë paraparë edhe implikimet buxhetore?

**Bedri Bahtiri** – Tha se me këtë ligj themelohet Agjencioni, ndërsa organogrami rregullohet me akte nënligjore.

**Kryetari** – Shtroi pyetjen: përse Ministria ta themelojë Agjencionin.

**Bedri Bahtiri** – Lidhur me përgjigjen e kësaj pyetjeje shtoi se ministria nuk e themelon Agjencionin, por Ligji dhe se Agjencioni është në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

**Ibrahim Makolli** – Në diskutimin e tij shtroi çështjen; përse Agjencioni nuk është në kuadër të Qeverisë ose Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, po është në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, kur puna e këtij Agjencioni ndërlihet edhe me prokurori, gjykata etj.

**Kryetari** - Propozoi që neni 3 të riformulohet, sepse të lihet ashtu është gabim. U propozua që në rreshtin 3, të hiqet fjala “*ministra*” dhe të vazhdojë teksti. Ky propozim u miratua nga anëtarët e Komisionit, ndërsa pika 4, e nenit 6, bartet te neni 7, pika e parë. Edhe ky propozim i faktorit ndërkombëtar u miratua nga Komisioni, kurse te neni 9, shtohet paragrafi 9.5 me përmbajtje, si vijon: “Mjetet nga shitja e pasurisë së konfiskuar pas vendimit përfundimtar të gjykatës derdhen në buxhetin e Kosovës”; kurse neni 10.1 riformulohet, si vijon: “Çdo personi fizik ose juridik, të cilit i është sekuestruar ose konfiskuar pasuria, ka të drejtë të kërkojë dhe të informohet nga agjencia për pasurinë e tij të sekuestruar ose të konfiskuar”. Edhe neni 12.2 riformulohet “Brenda gjashtë muajve, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria duhet të nxjerrë akte nënligjore që burojnë prej tij”. Këto propozime u përkrahen nga anëtarët e Komisionit. Gjithashtu u tha se me një amendament duhet të korrigjohen edhe gabimet në gjuhën angleze dhe në gjuhën serbe, sepse ka gabime në përkthimet nga gjuha shqipe.

*Pas diskutimit për këtë pikë të rendit të ditës Komisioni miratoi amendamentet e propozuara nga anëtarët e tij.*

#### **4. Të ndryshme**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, duke vepruar në pajtim me autorizimet e përcaktuara në fushëveprimin e vet, për bazë juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës shqyrtoi: Projektligjin për bujqësinë dhe për zhvillimin rural.

Komisioni vlerësoi se Projektligji i theksuar ka bazë juridike në nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe rekomandon të procedohet për shqyrtim të mëtutjeshëm për t’u miratuar në një nga seancat e Kuvendit.

**Kryetari** - I njoftoi të pranishmit edhe për një kërkesë drejtuar Komisionit, që ka të bëjë me dhënien e provimit të jurisprudencës, si dhe me një Cv të Fetije Sadikut, kandidate e propozuar për anëtare në Komisionin për dhënien e provimit të jurisprudencës.

Kryetari i falënderoi edhe një herë të pranishmit dhe në orën 12:20 e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Procesverbali u hartua nga Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

---

Bahri Hyseni